



## Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, Gjykatësi i Vetëm më 22 maj pranoi si provë një aktekspertizë të dorëzuar prej Mbrojtjes pasi konstatoi se ajo ishte relevante për çështjen gjyqësore, se eksperti në fjalë kishte kualifikimet përkatëse dhe se ishte autentike, pasi ishte e qartë cili ishte autori i aktekspertizës. Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm mbajti parasysh se Prokuroria nuk kundërshtoi pranimin e aktekspertizës dhe rikujtoi se aspektet metodologjike që kontestohen prej palëve dhe relevanca e opinioneve të ekspertit lidhen me peshën që do t'i jepet aktekspertizës dhe dëshmisë, që do të vlerësohet prej Gjykatësit të Vetëm në kuadër të tërësisë së provave të pranuar gjatë gjykimin.

Për kujtesë: Gjykatësi i Vetëm u kishte kërkuar palëve të përgatisnin dosjet gjyqësore përfundimtare deri më 19 qershor 2026, ose brenda një kohe të shkurtër më pas.

Në gjykimin *Thaçi the të tjerët*, në çështjen gjyqësore për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, u bë publik versioni i redaktuar publik i dosjes gjyqësore përfundimtarë të Prokurorisë, i datës 20 janar, dhe mund të gjendet në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

Parashtrimet e protokolluara publike në Dhomat e Specializuara janë të qasshme për publikun menjëherë pasi lëshohen. Gjykatësit gjithashtu sigurojnë që parashtrimet e protokolluara më parë si konfidenciale të bëhen publike sa më parë, ose që versionet e redaktuara publike të lëshohen në momentin më të hershëm të mundshëm.

